



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P.538/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.07.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Bahas” shpk në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-11166-05-04-2017, me objekt “Rikonstruksion i rrugës (Pedonale mbi Përroin e Gjerezës)”, me fond limit 28.478.274 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 29.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia e Tiranës.

Ankimues: “Dajti Park 2007“ shpk
Godinë banimi dhe shërbimesh 3,4 katë +nencati+
2 kate bodrum, kt.1, lagjia Qesarakë, Njësia
Administrative Dajt Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia e Tiranës
Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1000, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator i ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.05.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-11166-05-04-2017, me objekt “Rikonstruksion i rrugës (Pedonale mbi Përroin e Gjerezës)”, me fond limit 28.478.274 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 29.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia e Tiranës.

II.2. Në datën 29.05.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 08.06.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- “Nika” shpk	20.673.834 lekë	I skualifikuar
- BO “Klajger”& “Neal”	23.089.835 lekë	I skualifikuar
- “Bahas” shpk	23.819.470 lekë	I kualifikuar

- | | | |
|---------------------|-----------------|----------------|
| - “Dajti Park” shpk | 25.352.031 lekë | I kualifikuar |
| - “Caushi” shpk | 25.475.251 lekë | I skualifikuar |

II.4. Në datën 08.06.2017 operatori ekonomik “Dajti Park 2007“ shpk, është njoftuar mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si dhe për renditjen e operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.

II.5. Në datën 15.06.2017 operatori ekonomik “Dajti Park 2007“ shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Bahas”shpk. Konkretisht ankimuesi në ankesën e tij pretendon si më poshtë:

“Në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Bahas” shpk, mendojmë se ky operator nuk i përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST, nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë. Për këtë arsye kërkojmë që të rishikohen dhe kontrollohen edhe njëherë të gjitha dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik “Bahas” shpk”.

II.6. Në datën 20.06.2017, me shkresën nr. 23611/2 prot, operatori ekonomik ankimues “Dajti Park 2007“ shpk është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 29.06.2017 operatori ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.25543/1 prot, datë 04.07.2017 protokolluar me tonën me numër 1085/2, datë 06.07.2017 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ngritura nga “Dajti Park 2007” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në ankesën drejtuar pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” shpk nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* për operatorët e tjerë ekonomikë të kualifikuar.

III.1.2. Referuar VKM nr. 184, datë 17.03.2010, *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar*, Komisioni i

Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës, sipas përcaktimeve të nenit 17, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3: “Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”

III.1.3. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tyre, ankimesi duhet të kishin shoqëruar ankesën e tyre me prova, indicie dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ankesa. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.012.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga Autoriteti Kontraktor, pra ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik mbi bazën e pretendimeve a-priori të pa argumentuara të operatorëve ekonomik ankimes të cilët mund lehtësisht të ngrejne pretendime për të gjitha kriteret në dokumentat e tenderit por pa pasur asnjë provë apo indicie argumentuese se ku e bazojnë ankesën e tyre.

III.1.4. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë. Thëksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kritereve.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.1.6. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientësi e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krahasim të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

III.1.7. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi çënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.1.8. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Për rrjedhojë pretendimet e ankimuesit “Dajti Park 2007” shpk nuk merren shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-11166-05-04-2017, me objekt “Rikonstruksion i rrugës (Pedonale mbi Përroin e Gjerezës)”, me fond limit 28.478.274 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 29.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia e Tiranës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1185 Protokoli, Datë 29.06.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha